KËRKESË
Nr. 306/7, datë 24.7.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitim/rikonstruksion i Urës së Viroit", me vlerë totale paraprake të shpronësimit 700,000 (shtatëqind mijë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "vresht", bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar; marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 80/2023, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin 'Ndërtimi i urave të qëndrueshme duke përdorur qasjen e programit me shumë faza"', në bazë të të cilave është hartuar plani i veprimit të zhvendosjes, i shkurtuar, për projektin "Rehabilitim/rikonstruksion i Urës së Viroit", sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 700,000 (shtatëqind mijë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIN RRUGOR "REHABILITM/ RIKONSTRUKSION URA E VIROIT"

N/R	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas zvrpp)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË											VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
								Shpronësim tokë "Vreshtë"			Shpronësim tokë "Truall"			Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jo banimi		Vl. kult.		
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Ndërt. konf. ZVRPP (m2)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2)	Vlera sipas Preventivit (lekë)	Bujq. Dru-frut. (lekë)		
1	MIHAL	SOFO	CIKO	8541	110/1	VRESHTË	1000	41	6000	246.000			0			0			106.000	352.000	(Kartela e Pasurisë) SEKSIONI D TRUALL BIE PJESËRISHT NJË NDËRTIM I PALIGJSHËM
2	ARBEN	MUHARREM	ZHUPA	8541	110/2	VRESHTË	1000	42	6000	252.000			0			0			66.000	318.000	(Kartela e Pasurisë) SEKSIONI D TRUALL BIE PJESËRISHT NJË NDËRTIM I PALIGJSHËM
3	SADIK	MALIQ	KOTLLI	8541	110/3	VRESHTË	1000	5	6000	30.000			0			0			0	30.000	(Kartela e Pasurisë) SEKSIONI D NDALOHEN VEPRIMET DERI NË PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR
4	SHTET			8541	201/129	KANAL	1371	229	0	0						0			0		
5	SHTET			8541	201/71	RRUGË	5048	540	0	0						0			0		
6	SHTET			8541	201/109	LEDH	997	64	0	0						0			0		
SHUMA PARAPRAKE																				700.000	